

L I G J
Nr.8467, datë 31.3.1999

**PËR KOMPETENCAT E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SI KOMANDANT I
PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA DHE TË KËSHILLIT TË
SIGURIMIT KOMBËTAR**

Në mbështetje të neneve 81, 84, 168 dhe 169 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I :

Neni 1

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të funksionimit, të përbërjes së Këshillit të Sigurimit Kombëtar dhe të kompetencave të Presidentit të Republikës si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

**KREU I
PRESIDENTI I REPUBLIKËS SI KOMANDANT I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË
ARMATOSURA**

Neni 2

Presidenti i Republikës është Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura. Ai drejton të gjithë veprimtarinë e tyre në kohë paqe dhe në kohë lufte.

Presidenti i Republikës, në kohë paqe e ushtron drejtimin e Forcave të Armatosura nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 3

Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, emëron e shkarkon Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, si dhe, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, emëron e shkarkon komandantët e forcave tokësore, detare dhe ajrore.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm është përgjegjës përpara Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes për përgatitjen dhe gatishmërinë luftarake të ushtrisë, si dhe për drejtimin dhe organizimin e operacioneve ushtarake të Forcave të Armatosura.

Neni 4

Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura ka këto kompetenca:

1. Drejton, kontrollon dhe verifikon në çdo kohë zbatimin e programeve dhe respektimin e rregullave që lidhen me gatishmërinë luftarake të Forcave të Armatosura, me përjashtim të rasteve kur janë kompetencë e organeve të tjera të përcaktuara me ligj.
2. Miraton planin operativ-strategjik të mbrojtjes së vendit.
3. Miraton strukturën organizative të Forcave të Armatosura e të formacioneve të mbrojtjes, si dhe limitet e tyre.
4. Emëron, transferon dhe vendos për marrjen e masave disiplinore ndaj oficerëve të lartë

me gradën gjeneral.

5. Vendos për mobilizimin e efektivave, të njërive, si dhe për lëvizjen dhe vendosjen e tyre jashtë rajonit të dislokimit të përhershëm.

6. Në rast agresioni të armatosur kundër Republikës së Shqipërisë, me kërkesën e Këshillit të Ministrave, shpall gjendjen e luftës.

7. Në kohë lufte, me propozim të Kryeministrit, emëron dhe shkarkon Komandantin e Forcave të Armatosura.

8. I propozon Kuvendit shpalljen e gjendjes së luftës dhe vendos gjendjen e mobilizimit të çmobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm në rast kërcënimesh që vijnë nga jashtë territorit të Republikës ose kur detyrimi buron nga një marrëveshje ndërkombëtare për mbrojtje të përbashkët.

9. Urdhëron dhënien e sinjalit të kushtrimit ajror në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

10. Në rast agresioni, kur sulmohet territori i Republikës së Shqipërisë, urdhëron për hapjen zjarr mbi forcat dhe mjetet tokësore, detare dhe ajrore të huaja.

11. Në kohë lufte, me propozim të Komandantit të Forcave të Armatosura, vendos për përdorimin e Forcave të Armatosura në operacionet ushtarake.

12. Vendos dhe përcakton mënyrën e zhvillimit të bisedimeve me forcat kundërshtare.

13. I propozon Kuvendit përfundimin e gjendjes së luftës.

14. Urdhëron vendosjen e shkallëve të ndryshme të gatishmërisë luftarake në Forcat e Armatosura në kushtet e masave të jashtëzakonshme.

15. Urdhëron lëvizjen, dislokimin dhe përdorimin e Forcave të Armatosura në kushtet e masave të jashtëzakonshme.

Neni 5

Presidenti i Republikës si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura nxjerr urdhra në ushtrimin e kompetencave të tij.

KREU II KËSHILLI I SIGURIMIT KOMBËTAR

Neni 6

Këshilli i Sigurimit Kombëtar e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të Kushtetutës, ligjeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi.

Neni 7

Këshilli i Sigurimit Kombëtar është organ këshillimor i Presidentit të Republikës në fushën e sigurimit kombëtar.

Këshilli i Sigurimit Kombëtar thirret dhe drejtohet nga Presidenti i Republikës mbi bazën e një rendi dite të përcaktuar.

Këshilli i Sigurimit Kombëtar ka për detyrë të ndihmojë Presidentin e Republikës në drejtimin, organizimin dhe mobilizimin e burimeve njerëzore dhe materiale për sigurimin kombëtar të vendit.

Neni 8

Këshilli i Sigurimit Kombëtar diskuton dhe jep mendime:

1. për politikën e shtetit në lidhje me projektudhëzimet e përgjithshme të natyrës

ushtarake, organizative dhe teknike të cilat kanë të bëjnë me përgatitjen e vendit për mbrojtje;

2. për strukturën organizative të Forcave të Armatosura e të formacioneve të mbrojtjes si dhe limitet e tyre;

3. për krijimin dhe funksionimin e shtabeve të mbrojtjes në të gjithë vendin;

4. për drejtimet kryesore të planifikimit, ndërtimit të mbrojtjes operativo-strategjike të vendit, të stërvitjes e të gatishmërisë luftarake, të pajisjes materialo-teknike dhe të fuqizimit e të modernizimit të Forcave të Armatosura;

5. për drejtimet kryesore të zhvillimit të industrisë ushtarake dhe të përgatitjes së mbrojtjes civile të vendit;

6. për kompetencat e komandave ushtarake për mobilizimin e efektivave të njësisë, si dhe për lëvizjen e vendosjen e tyre jashtë rajonit të dislokimit të përhershëm;

7. për krijimin dhe shkrirjen e njësive dhe të reparteve të Ministrisë së Mbrojtjes për hallkën batalion e lart;

8. për masat për ruajtjen dhe mbrojtjen e rendit publik në rast gjendjeje të jashtëzakonshme ose lufte;

9. për angazhimin dhe vënien në dispozicion të frontit të luftës të të gjitha burimeve dhe të mjeteve materiale të domosdoshme;

10. për dokumentin e politikës së sigurimit kombëtar, të mbrojtjes së vendit, për doktrinën ushtarake, për rregulloret e disiplinës e të jetës së brendshme dhe të gatishmërisë luftarake të Forcave të Armatosura.

Këshilli i Sigurimit Kombëtar i rekomandon Këshillit të Ministrave ndryshime në buxhetin ushtarak, në varësi të nevojave për përballimin e gjendjes së luftës ose për krijimin e njësive të reja ushtarake.

Neni 9

Anëtarë të Këshillit të Sigurimit Kombëtar janë këta funksionarë:

1. Kryetari i Kuvendit
2. Kryeministri
3. Ministri i Mbrojtjes
4. Ministri i Punëve të Jashtme
5. Ministri i Rendit Publik
6. Ministri i Ekonomisë dhe Privatizimit
7. Ministri i Financave
8. Ministri i Punëve Publike dhe Transporteve
9. Ministri i Pushtetit Lokal
10. Ministri i Shëndetësisë
11. Kryetari i Shërbimit Informativ Kombëtar (drejtori i shërbimit informativ të shtetit)
12. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë
13. Komandanti i Forcave të Armatosura, vetëm në kohe lufte.

Neni 10

Ligji nr.7528, datë 11.12.1991 “Për funksionet e Këshillit të Mbrojtjes dhe të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura” shfuqizohet.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.2342, datë 2.4.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

Rexhep Meidani